

VENDIM
Nr. 88, datë 6.2.2026

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 417, DATË 26.6.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E VLERAVE PËR SECILIN ELEMENT PËRBËRËS TË PAGËS BRUTO MUJORE TË PUNONJËSVE TË GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, të ndryshuar, dhe të pikave 1, shkronja “a”, e 2, të nenit 48, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. 1, e vendimit nr. 417, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të Gardës së Republikës së Shqipërisë”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat e elementit “paga për gradë”, në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, janë rezultat i indeksimit në masën 2.5% dhe i politikës së rritjes së pagave për punonjësit me gradën “Inspektor”, “Inspektor i dytë”, “Inspektor i parë” dhe “Nënkomisar” dhe rezultat i indeksimit në masën 2.5% për gradat e tjera.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2026, përballohen nga buxheti i Gardës së Republikës së Shqipërisë, i miratuar në ligjin nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2026.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 1

Paga për gradë për punonjësit e Gardës së Republikës së Shqipërisë

Roli i punonjësve sipas gradave	Grada	Paga për gradë
Për punonjësit e nivelit madhor	Drejtues Madhor	184 500
	Drejtues i lartë	164 000
Për punonjësit e nivelit të lartë	Drejtues i parë	138 375
	Drejtues	123 000
Për punonjësit e nivelit të mesëm	Kryekomisar	107 625
	Komisar	97 375
	Nënkomisar	88 000
Për punonjësit e nivelit bazë	Inspektor i parë	83 000
	Inspektor i dytë	78 000

	Inspektor	73 500
--	-----------	--------